



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË

PROJEKT VENDIM

Nr. Datë

PËR MIRATIMIN E MBËSHTETJES FINANCIARE TË PROJEKTIT ARTISTIK-KULTUROR “BOTIMI I LIBRIT ‘QYTETI PREJ LETRE’”

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, në buxhetin e Bashkisë Kolonjë për vitin 2026 në ligjin Nr.10352, datë 18.11.2010 për Artin dhe Kulturën, në kërkesën e Fondacionit “Instituti i Librit dhe i Promocionit”, si dhe në vendimin e Këshillit Artistiko-Kulturor të Drejtorisë së Artit, Kulturës dhe Sportit për miratimin e projektit artistik-kulturor “Botimi i librit ‘Qyteti prej Letre’”, këshilli bashkiak

PROPOZOI:

1. Të miratojë mbështetjen financiare të projektit artistik-kulturor “Botimi i librit ‘Qyteti prej Letre’”, paraqitur nga Fondacioni “Instituti i Librit dhe i Promocionit”.
2. Mbështetja financiare të akordohet nga fondi i miratuar për projektet artistike dhe kulturore të Bashkisë Kolonjë për vitin 2026, sipas vlerës së miratuar nga strukturat përgjegjëse.
3. Drejtoria e Artit, Kulturës dhe Sportit, të ndjekin procedurat për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve ligjore në fuqi

KRYETARI I BASHKISË
ERION ISAI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
KËSHILLI I BASHKISË

RELACION PËR
PROJEKT-VENDIM
Nr. Datë /06/ 2026

PËR MIRATIMIN E MBËSHTETJES FINANCIARE TË PROJEKTIT ARTISTIK-KULTUROR “BOTIMI I LIBRIT ‘QYTETI PREJ LETRE’”

TË NDERUAR!

Në kuadër të thirrjes së hapur për projekte artistike dhe kulturore të shpallur nga Drejtoria e Artit, Kulturës dhe Sportit pranë Bashkisë Kolonjë për vitin 2026, Fondacioni “Instituti i Librit dhe i Promocionit” ka paraqitur për mbështetje projektin “Botimi i librit ‘Qyteti prej Letre’”, me autor z. Rinalt Kasko.

Projekti është shqyrtuar nga Këshilli Artistiko-Kulturor, i cili ka vlerësuar se ai përmbush kriteret e përcaktuara në thirrjen publike dhe ka vendosur miratimin e tij si një projekt me vlera letrare, artistike dhe kulturore për komunitetin e Bashkisë Kolonjë.

Libri “Qyteti prej Letre” përfaqëson një krijimtari poetike që trajton tema të lidhura me identitetin, kujtesën, vendlindjen dhe përjetimet njerëzore. Një pjesë e rëndësishme e poezive i kushtohen qytetit të Ersekës dhe trevës së Kolonjës, duke evidentuar peizazhin, historinë, traditat dhe elementët identitarë të zonës.

Botimi dhe promovimi i kësaj vepre nuk përbën vetëm mbështetje për krijimtarinë letrare bashkëkohore, por shërben edhe si një mjet për promovimin e vlerave kulturore, historike dhe turistike të Bashkisë Kolonjë. Përmes përmbajtjes së tij, libri kontribuon në njohjen dhe përcjelljen e identitetit lokal tek publiku, duke promovuar Kolonjën si një territor me tradita, kulturë dhe potencial të pasur krijues.

Mbështetja e këtij projekti është në përputhje me objektivat e Bashkisë Kolonjë për zhvillimin e jetës kulturore, mbështetjen e autorëve dhe artistëve vendas, si dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe vlerave identitare të zonës.

Për sa më sipër, propozohet miratimi i mbështetjes financiare për projektin artistik-kulturor “Botimi i librit ‘Qyteti prej Letre’”, si një projekt që kontribuon në pasurimin e jetës kulturore dhe në promovimin e vlerave identitare të Bashkisë Kolonjë.

PUNOI: Eni Duro

KONFIRMOI: Drejtori D.Ç.J.P.P O.LIFO